



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësia:		Mr. Prot.:	
Unit:	KO	Prot. No.:	25/2022
Jedinica:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:		Data:	23.06.2022
No. of pages:	-10-	Date:	
Br. atranica:		Datum:	
		Prishtinë	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RREGULLORE E PUNËS E KËSHILLIT
MBIKQYRËS TË OMK-së

Prishtinë, Qershor 2022

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe Nenit 23 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22 paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 dhe Nenin 33 të Statutit të OMK-së, si dhe Nenit 24 dhe 25 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, e miratuar në mbledhjen e datës 22 qershor 2017, në mbledhjen e rregullt të datës 23 qershor 2022, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

RREGULLORE E PUNËS E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË OMK-së

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit me nr. KO 22/2022 të Kuvendit të OMK-së, datë 23 qershor 2022)

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat, rregullat, kriteret dhe kompetencat e pavarura të Këshillit Mbikqyrës të Odës së Mjekëve të Kosovës dhe zbatimit të tyre në praktikë (më tutje në tekst Oda e Mjekëve të Kosovës: OMK)

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Këshilli Mbikqyrës i Odës së Mjekëve të Kosovës dhe përcakton procedurat vendimmarrëse të këtij organi.

Neni 3

Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1.**OMK**-nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës;

1.2.**KM**-nënkupton Këshillin Mbikqyrës si organ i Odës së Mjekëve të Kosovës;

1.3.**Kryesuesi i mbledhjes**-nënkupton kryetarin, zëvendëskryetarin apo personin e autorizuar , i cili drejton mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës;

1.4. **Konflikti i interesit**-nënkupton rrethanën në të cilën anëtari ka interes privat, që mund të ndikoj apo duket se po ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të funksionit të tij si anëtar i Këshillit Mbikqyrës.

2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

Neni 4

Themelimi dhe përgjegjësitë e Këshillit Mbikqyrës të OMK

1. Oda e Mjekëve të Kosovës përmes punimeve të Kuvendit të saj, themelon Këshillin Mbikqyrës të OMK-së, nga radhët e anëtarëve të tij në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarëve.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës votohen përmes anëtarëve të Kuvendit të OMK-së, nga radhët e të cilëve zgjidhet Kryetari dhe Nën-Kryetari i Këshillit Mbikqyrës në pajtim me Kodin Zgjedhor të OMK-së.
3. Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe 3 (tre) anëtarë të Këshillit i zgjedhë Kuvendi i OMK-së nga radha e anëtarëve të saj në pajtim me Kodin Zgjedhor të OMK-së, ndërsa 2 (dy) anëtarë të tjerë delegohen nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Anëtarët e këtij Këshilli nuk mund të jenë edhe anëtar të Këshillave dhe Komisioneve tjera brenda OMK-së.

Neni 5

Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës të OMK-së

1. Mbikëqyr dhe përcjellë afarizmin financiar të OMK-së.
2. Mbikëqyr dhe përcjellë realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të OMK-së, si dhe çdo vendim të nxjerrë nga organet e OMK-së.
3. Mbikëqyr dhe përcjellë punën e Shërbimit Profesional të OMK-së.
4. I propozon Këshillit Drejtues të OMK-së, marrjen e masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson se ka shkelje ligjore të akteve të miratuara nga Kuvendi i Odës, përmes rekomandimeve dhe kërkesave me shkrim.
5. Këshilli Mbikqyrës i OMK-së për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Odës.
6. Këshilli Mbikqyrës i OMK-së shqyrton dhe miraton raportet periodike të punës dhe të njejtat raporte ia paraqet Kuvendit të OMK-së.

Neni 6

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Anëtarëve të KM të OMK-së

1. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të OMK-së kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.1. Të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e KM të OMK-së;

1.2. Të paraqesin propozimet/rekomandimet e tyre për pikat e rendit të ditës në pajtim me procedurat e parapara sipas kësaj rregulloreje;

1.3. Të kenë qasje dhe tu ofrohen dokumentet dhe materialet e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tyre;

1.4. T'u përmbahen rendit të ditës dhe rregullave gjatë mbledhjeve;

1.5. Kujdesen për zbatimin e plotë të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetsorë, Statutit të OMK-së, Rregullores së punës së KM të OMK-së si dhe aktet tjera normative dhe juridike të OMK-së.

1.6. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, janë të obliguar që 1 (një) herë në 6 (gjashtë) muaj apo 2 (dy) herë brenda vitit kalendarik ta përpilojnë raportin e punës lidhur me punën dhe aktivitetet e Këshillit Mbikqyrës, të cilin ia prezantojnë Kuvendit të OMK-së.

1.7. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës kanë të drejtë të jenë aktiv në mbikqyrjen e zhvillimeve të OMK-së, të ndërhyjë apo të participojë në përpilimin e Rregulloreve të OMK-së.

1.8. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës kanë të drejtë të jenë aktiv në zhvillimin e aktiviteteve të KM-së dhe të kërkojnë sqarime mbi veprimtarinë e KM-së.

2. Zyrtarët e Shërbimit Profesional të OMK-së, sipas nevojës dhe kërkesës do të ofrojnë asistencë profesionale dhe administrative anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të OMK-së.

Neni 7

Kompetencat e Kryetarit të KM të OMK-së

1. Kryetari i KM të OMK-së ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

1.1. Thërret mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme;

- 1.2. Kujdeset për zbatimin e plotë të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetsor, Statutit të OMK-së, Rregullores së punës së KM të OMK-së si dhe aktet tjera normative dhe juridike të OMK-së;
 - 1.3. Përpilon dhe propozon rendin e ditës të mbledhjeve të mbledhjeve të KM të OMK-së;
 - 1.4. Kryeson mbledhjet e KM dhe kujdeset për rregullsinë e mbajtjes së mbledhjes si dhe rendit të ditës;
 - 1.5. Në mungesë të zëvendëskryetarit autorizon njërin nga anëtarët e KM për të drejtuar mbledhjen;
 - 1.6. Interpretton dispozitat e kësaj rregulloreje;
 - 1.7. Kujdeset për çështje të tjera që janë të nevojshme për funksionimin e KM-së.
2. Në rast të mungesës së kryetarit, të gjitha kompetencat nga paragrafi 1 i këtij neni do ti ushtrojë zëvendëskryetari i KM-së.

Neni 8

Mandati i Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe Anëtarëve të KM të OMK-së

1. Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e KM kanë mandat 4 (katër) vjeçar.
2. Kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të KM mund tu ndërpritet mandati para përfundimit të tij të plotë, për shkaqet si në vijim:
 - 1.1. Me shkarkim nga Kuvendi i OMK-së;
 - 1.2. Me dhënie të dorëheqjes me shkrim;
 - 1.3. Në rast të shqiptimit të masës disiplinore sipas vendimit të Këshillit Etik të OMK-së;
 - 1.4. Me humbjen e statusit të anëtarit të OMK-së;
 - 1.5. Me vdekjen e anëtarit të Këshillit;
 - 1.6. Në rast të ndërrimit të vendit të punës;
 - 1.7. Në rast të pensionimit;
 - 1.8. Nëse pa arsye mungon 3 (tre) herë radhazi në mbledhje të rregullta të Këshillit.
3. Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e larguar nga KM zëvendësohen në pajtim me aktin normativ për zgjedhjet e brendshme në OMK.

Neni 9

Mbledhjet e KM të OMK-së

1. Këshilli Mbikqyrës mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
2. Mbledhjet e rregullta mbahen së paku njëher në muaj.
3. Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të KM-së më shumë se njëher në muaj ,sipas nevojës dhe problematikës së procesit të mbikëqyrjes së proceseve në OMK, i thërret Kryetari ose me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të KM-së.
4. Ftesa për mbledhje me rendin e propozuar të ditës u dërgohet anëtarëve të KM së paku tri ditë më heret.
5. Ftesa për mbledhje të jashtëzakonshme së bashku me rendin e ditës ju dërgohet anëtarëve të KM-së, së paku 24 orë para mbajtjes së mbledhjes.
6. Në çdo mbledhje të Këshillit Mbikqyrës, Kryesuesi verifikon pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, ku për mbajtjen e mbledhjeve të KM-së duhet të ketë kuorum prej së paku 4 (katër) anëtarëve të cilët duhet të jenë prezent në takim.
7. Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës shtyhet ose ndërpritet në rastet kur nuk ka kuorum, dhe në rastet kur mbledhja nuk mund të kryhet në kohën e planifikuar (zgjatë më shumë se koha e planifikuar).
8. Mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës e shtynë dhe e ndërpret Kryetari i Këshillit, në mungesë të tij shtyrjen dhe ndërprerjen e mbledhjes e bënë Zv.kryetari i Këshillit Mbikqyrës apo anëtari i KM-së të cilin Kryetari e ka autorizuar që ta udhëheqë mbledhjen.
9. Administrimin e materialit për mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës e përgatitë Kryetari i Këshillit Mbikqyrës në konsultim, koordinim dhe bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të Shërbimit Profesional të OMK-së.

Neni 10

Procesverbali

- 1.Për punën e zhvilluar dhe rrjedhën e mbledhjeve të KM-së mbahet procesverbali.
- 2.Procesverbali mbahet nga zyrtari administrativ i caktuar për të ofruar asistencë administrative pranë KM-së.

3. Procesverbali përmban të dhënat kryesore mbi rrjedhën e mbledhjes, mbi rendin e ditës, mbi shqyrtimet dhe diskutimet, si dhe për votimet, vendimet dhe rekomandimet e aprovuara.
4. Procesverbali duhet të përmban patjetër rezultatin e votimit për vendimet e marra në mbledhje.
4. Secili anëtarë i KM-së ka të drejtën e tij/saj që në procesverbal të potencohet vota e tij, si dhe të kërkoj plotësim ndryshimin e procesverbalit me vërejtjet e bëra.
5. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikqyrës ruhen në arkivin e OMK-së.

Neni 11

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Mbledhjet e KM kanë korum nëse në mbledhje janë prezent së paku katër (4) anëtarë.
2. Prezencën e anëtarëve e konstaton Kryesuesi i mbledhjes dhe konstatimi i tillë evidentohet në procesverbal.
3. Në mungesë të korumit, kryesuesi i mbledhjes së KM e ndërpret mbledhjen deri në caktimin e mbledhjes së radhës duke e theksuar arsyen në procesverbalin e mbledhjes së thirrur.
4. Për çështjet në të cilat KM vendos në procedurë të votimit, vendimmarrja bëhet me shumicë të votave të anëtarëve prezent që e përbëjnë kuorumin e mbledhjes.
5. Në rast se kemi numër të barabartë të votave, atëherë vendos vota e Kryetarit të KM-së.
6. Votimi në procedurat vendimmarrëse të KM bëhet në këto mënyra:
 - 6.1. Votimi i hapur, me ngritje të dorës: “për”, “kundër” dhe “abstenim”;
 - 6.2. Votim i fshehtë nëse kështu vendosin shumica e anëtarëve prezent që e përbëjnë kuorumin;
 - 6.3. Votim qarkullues apo i regjistruar që përfshin votimin me shkrim ose elektronik; dhe
 - 6.4. Votimin duke e thirrur secilin anëtar të KM veç e veç.
7. Mbledhjen e KM-së, e hap kryesuesi i mbledhjes i cili në fjalën hyrëse konstaton kuorumin dhe rendin e ditës.
8. Në rast se anëtarët e KM-së parashtrojnë vërejtjet e tyre dhe për pretendimet e tilla nuk paraqiten kundërshtimet nga anëtarët tjerë që janë prezent, kryesuesi do të hedhë në votim procesverbalin me vërejtjet e parashtruara. Procesverbali me ose pa vërejtjet e paraqitura miratohet me votimin e shumicës së anëtarëve të pranishëm që përbëjnë kuorumin.

9. Nëse ndaj vërejtjeve të paraqitura nga anëtarët e KM-së lidhur me procesverbalin paraqiten kundërshtime, atëherë kryesuesi vërejtjen e kundërshtuar do ta hedhë në votim të veçantë dhe varësisht nga miratimi apo refuzimi, vërejtja e tillë futet në procesverbal.

Neni 12

Rendi i ditës

1. Kryesuesi i mbledhjes, konstaton se anëtarëve u është dërguar rendi i ditës së bashku me materialet përcjellëse dhe më pas e hedh në votim rendin e ditës, i cili konsiderohet se është miratuar me votim të shumicës së anëtarëve prezent që përbëjnë kuorumin.
2. Kryesuesi i mbledhjes, do t'u jap mundësi anëtarëve që të deklarohen dhe të paraqesin propozimet e tyre lidhur me rendin e ditës. Çdo propozim i paraqitur duhet që të aprovohet nga mbledhja e KM-së, nga shumica e anëtarëve prezent që përmbushin kuorumin.
3. Diskutimi gjatë shqyrtimit të rendit të ditës kufizohet në kohëzgjatje prej 3 (tre) minutave.
4. Rendi i ditës për mbledhje të jashtëzakonshme i propozuar nuk mund të ndryshohet apo plotësohet gjatë mbajtjes së mbledhjes por si i tillë miratohet apo nuk miratohet nga anëtarët e KM-së.

Neni 13

Mbarëvajtja e mbledhjeve

1. Mbledhja fillon sipas rendit të paraparë të ditës.
2. Kryesuesi i mbledhjes deklaron hapjen e diskutimit të çështjes sipas pikës së rendit të ditës të aprovuar nga KM. Nëse për pikën e rendit të ditës për të cilën ka filluar diskutimi ekziston materiali përcjellës, kryesuesi i mbledhjes e prezenton materialin në fjalë.
3. Pas prezentimit të pikës së rendit të ditës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, kryesuesi i mbledhjes e hap diskutimin për pikën e rendit të ditës. Anëtarët e interesuar për diskutim lajmërohen për të folur. Diskutimi i anëtarit kufizohet në 5 (pesë) minuta. Në raste kur anëtari kërkon fjalën për herë të dytë brenda diskutimit të pikës së njëjtë të rendit të ditës, atëherë diskutimi zgjatë 2 (dy) minuta.
4. Gjatë diskutimit të tyre anëtarët janë të obliguar që t'i përmbahen rendit të ditës. Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen anëtarit dhe t'i kërkojë që t'i përmbahet diskutimit lidhur me pikën e rendit të ditës. Nëse anëtari nuk i bindet vërejtjes së kryesuesit të mbledhjes, ndaj tij mund të merren masat që janë të parapara me këtë rregullore.

5. Anëtarët e KM-së kanë të drejtë në replikë në rast se përmendet emri i tyre nga anëtari tjetër i KM-së. E drejta për replikë mund të kërkohet menjëherë pas përfundimit të fjalimit në të cilin anëtari ia ka përmendur emrin replikuesit.Replika kufizohet në 2 (dy) minuta.
6. Anëtari, diskutimi i të cilit është replikuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, ka të drejtë në kundër replikë në kohëzgjatje prej 1(një) minute, me kusht që këtë ta këtë kërkuar menjëherë pas replikës.
7. Pas përfundimit të diskutimeve të paraqitura nga anëtarët e KM-së, kryesuesi konstaton se është mbyllur diskutimi për atë pike të rendit të ditës.
8. Varësisht nga natyra dhe përmbajtja e pikës së rendit të ditës, kryesuesi do t'i hedhë në votim propozimin/et e konkluduar/a.
9. Asnjë anëtarë nuk mund ta marrë fjalën pa lejen e kryesuesit të mbledhjes.
10. Anëtarët e KM-së gjatë diskutimeve të tyre duhet të përmbahen nga fjalori ofendues dhe i papranueshëm.
11. Në rast të mosrespektimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje, kryesuesi ka të drejtë që t'ia tërheqë vërejtjen anëtarit për prishjen e rendit dhe qetësisë në mbledhje.
12. Nëse anëtari i KM-së nuk i bindet vërejtjes së dhënë, kryesuesi ka të drejtë që:
 - 12.1. Të kërkojë nga anëtari që ta tërheqë fjalën;
 - 12.2. Të kërkojë nga anëtari që të kërkojë falje për fjalorin ofendues;
 - 12.3. T'ia ndërpresë fjalën;
 - 12.4. Të kërkojë që anëtari ta lëshojë mbledhjen;
 - 12.5. Të iniciojë procedurën disiplinore në Gjyqin e Nderit ndaj anëtarit të KM-së, për shkak të sjelljes së pahijshme dhe prishjes së rendit dhe qetësisë në mbledhje.

Neni 14

Konflikti i interesit

1. Nëse një anëtar ka konflikt interesi me një çështje që paraqitet për shqyrtim në KM, ai nuk merr pjesë në mbledhje deri në vendosje për çështjen, e cila paraqitet si rrethanë e konfliktit të interesit.
2. Në rastet e paraqitjes së rrethanave që përbëjnë konflikt të interesit, anëtari i KM-së, i cili gjendet në kushte të tilla, është i obliguar që të deklarojë rrethanën e tillë në momentin që është në dijeni për këtë çështje.

3. Secili nga anëtarët e KM-së, kur është në dijeni se ndonjëri nga anëtarët e KM-së është në konflikt të interesit, është i obliguar që të deklarojë konfliktin e interesit të cilitdo anëtar të KM-së.
4. Për çështjet e tjera që nuk janë të specifikuar në këtë nen aplikohen dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
5. Për zbatimin e këtij neni do të kujdeset Kryetari i KM-së.

Neni 15

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Kuvendi i OMK-së.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njejtës procedurë së miratimit.

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen dispozitat e Rregullores e Punës së Këshillit Mbikqyrës të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK-së dhe nënshkrimit nga Kryetari i OMK-së.
3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, e njëjta duhet të publikohet në ueb-faqen zyrtare të OMK-së dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Prishtinë,
23 qershor 2022

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.Sci

